



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:086645

Datë: 24.04.2024

Numri i dokumentit: 05617062

PAKR.nr.603/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për Krime të Rënda me kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hashim Çollaku – kryetare e kolegjit, Kadrije Goga Lubishtani dhe Xhevdet Abazi anëtarë, më bashkëpunëtoren profesionale Blerina Sallauka, në çështjen penale kundër të akuzuarve E. P dhe F. S, që të dy për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 e lidhur me nenin 31 KPPRK-së, duke vendosur lidhur më ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit E. P, av. Emine Kaçiku si dhe ankesën e mbrojtëses të akuzuarit F. S, av. Fatmire Braha, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Krimeve të Rënda, P.nr.32/2017 i datës 12.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të KPPK-se, me datë 07.02.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit E. P, av. Emine Kaçiku si dhe ankesa e mbrojtëses të akuzuarit F. S, av. Fatmire Braha, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Krimeve të Rënda, P.nr.32/2017 i datës 12.07.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Krimeve të Rënda me aktgjykimin P.nr.32/2017 të datës 12.07.2023, në pikën I të dispozitivit të akuzuarin E. P për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31, të KPRK-së, e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vite, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, si dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej pesëqind euro (500 €), të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afatin prej 90 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë. Në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar nga Gjykata, Gjykata do të veprojë sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, duke zëvendësuar dënimin me gjobë me dënim me burgim, ku njëzet euro (20 €) të dënimit me gjobë llogariten me një (1) ditë burgim.

Ndërsa, në pikën II të dispozitivit të akuzuarin F. S për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31, të KPRK-së, e ka shpallur fajtor dhe i ka dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vite i cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, si dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej pesëqind euro (500 €), të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afatin prej 90 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë. Në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar nga Gjykata, Gjykata do të veprojë sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, duke zëvendësuar dënimin me gjobë me dënim me burgim, ku njëzet (20) euro të dënimit me gjobë llogariten me një (1) ditë burgim.

Të akuzuarve E. P dhe F. S në dënimin e shqiptuar me burgim do të iu llogaritet koha e kaluar në masën e paraburgimit dhe të arrestit shtëpiak prej datës 09.11.2016, e gjer më datën 07.02.2017.

Në bazë të nenit 69 par.1 dhe 2 të KPRK-së, Gjykata të akuzuarit E. P i ka shqiptuar dënimin plotësues - marrja e sendit.

Është konfiskuar automjeti i markës Renault Clio, me tabelat e regjistrimit ..., i cili është në emër të personit V. P, i cili është vëllai i te akuzuarit E. P, si send i përdorur për kryerjen e veprës penale.

Në bazë të nenit 273 par.5 të KPRK-së janë konfiskuar 504 copë tableta të narkotikut MDMA – e njohur si ekstazi me peshë të përgjithshme prej 207.77 gram dhe substanca narkotike e llojit marihuanë në sasi prej 0.62 gram. Pasi që aktgjykimi të marrë formën e prerë, të njëjtat duhet të shkatërrohen nga Policia e Kosovës.

Janë obliguar të akuzuarit E. P dhe F. S që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajnë secili veç e veç shumën prej tridhjetë (30) euro, ne emër te paushallit gjyqësor të paguajnë secili veç e veç shumën prej njëzetë (20) euro, ndërsa ne emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajnë secili veç e veç shumën prej pesëdhjetë (50) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Palë të dëmtuar sipas aktakuzës nuk pati.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë kanë ushtruar:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj sa i përket pretendimeve ankimore dhe ndaj të akuzuarve të shqiptoj dënim më të ashpër.

Mbrojtësja e të akuzuarit E. P, av. Emine Kaçiu, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, më propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoi ankesën si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta prish dhe lëndën ta kthej në rigjykim ose të njëjtin ta ndryshoj dhe të akuzuarin E. P ta liroj nga aktakuza ose në rastin më të keq të njëjtit t'i shqiptoj dënim shumë më të butë.

Mbrojtësja e të akuzuarit F. S, av. Fatmire Braha, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoj ankesën si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar t'a prish dhe lëndën t'a kthej në rigjykim apo që aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj ashtu që ndaj të mbrojturit tim të shqiptoj aktgjykim lirues.

Prokurori i Apelit më parashtrësën PPA/I.nr.546/2023 të datës 18.10.2023, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë dhe aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që të

akuzuarve t'iu shqiptohet dënim më i ashpër se sa në aktgjykimin e ankimuar, ndërsa të refuzohen ankesa e mbrojtëses të akuzuarit E. P, av. Emine Kaçiku dhe mbrojtëses të akuzuarit F. S, av. Fatmire Braha, si të pa bazuara.

Gjykata e Apelit e caktoj dhe e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPRK-së në të cilën mori pjesë i akuzuari E. P, i akuzuari F. S dhe mbrojtësja e të akuzuarit F. S, av. Fatmire Braha. Ndërsa Prokurori i Apelit dhe mbrojtësja e të akuzuarit E. P, av. Emine Kaçaniku, nuk prezantuan në seancë ndonjëse të njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt. Mbrojtësja e të akuzuarit F. S, av. Fatmire Braha në seancën e kolegjit deklaroi se ne mbesim në tërësi pranë ankesës. Ne konsiderojmë se dënimi është shumë i ashpër, për shkak se i mbrojturi im tashmë është martuar dhe në pritje të një fëmije, është ri socializuar, ka hapur biznes, paguan tatim dhe mbanë familjen. Andaj, i propozojmë Gjykatës që lëndën të e kthej në rigjykim, të e ndryshoj aktgjykimin dhe të sjell aktgjykim lirues ose nëse vërtetohet se tabletat janë substanca narkotike të mbrojturit tim të i shqiptoj dënim me kusht. I akuzuari F. S deklaroi se e mbështes avokaten, asnjëherë nuk kam punuar me këto punë dhe më vjen keq për rastin e ndodhur. I akuzuari E. P deklaroi se e mbështes ankesën e avokates. Unë nuk e ndjej vetën fajtor për këtë vepër penale dhe dua të theksoj se kam filluar të punoj dhe kam një kontratë të punës.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, studioj aktgjykimin e kundërshtuar konform dispozitës së nenit 394 të KPPRK-së dhe pasi që vlerësoi pretendimet ankimore në ankesa gjeti se:

Ankesat janë të pa bazuara.

Pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore Mitrovicë

Prokurori në ankesë thekson se Gjykata me aktgjykimin e ankimuar drejt ka vërtetuar gjendjen faktike si dhe drejt ka vepruar kur të akuzuarit i ka shpallur fajtor për veprën e kryer penale, mirëpo me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë të dënimit ka nxjerrë konkluzion të gabuar për arsye se dënimi i shqiptuar është i butë dhe jo adekuat në krahasim me veprën e kryer penale e posaçërisht pasojën konkrete dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale. Tutje, ka shtuar se Gjykata me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e dënimit ndaj të akuzuarit është dashur të ketë parasysh dhe të vlerësoj drejt rrethanat e parapara me Kodin e Procedurës Penale. Kjo sepse siç shihet nga arsyetimi i aktgjykimit me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ndaj të akuzuarve, Gjykata ka mbivlerësuar rrethanat lehtësuese duke mos u dhënë rëndësinë e duhur

rrethanave rënduese si: shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarve, kufijve të dashjes së tyre, faktit se këto vepra penale janë të shprehura dhe paraqesin rrezik për qytetarët dhe sigurinë e përgjithshme shoqërore.

Pretendimet ankimore të mbrojtëses së të akuzuarit E. P, av. Emine Kaçiu.

Mbrojtësja e të akuzuarit E. P, av. Emine Kaçiu në ankesë pretendon se Gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike sepse me asnjë provë dhe as përmes dëgjimit të ekspertit nuk ka arritur të vërtetoj se tabletat e cekura janë narkotik, pasi që të njëjtat nuk janë të regjistruara si narkotik në Ligjin për Barnat Narkotike. Ndërkaq, shton se për përmbushen e elementeve të veprës penale e cila i vihet barrë të akuzuarit E. P është esenciale që substancat apo preparatet e tillë të jenë të shpallura me ligj si narkotik. Për të mbështetur këtë pretendim, mbrojtja citon pjesë të deklaratës se ekspertit të dhënë në shqyrtim gjyqësor, si dhe shton që sipas pyetjeve të ushtruara nga Prokurori drejtuar ekspertit, rezulton se as vet Prokurori nuk ka qenë i sigurt në besueshmërinë e aktakuzës.

Po ashtu, mbrojtja pretendon se nuk është vërtetuar me asnjë prova as fakti se në mes të akuzuarit E. P dhe F. S ka ekzistuar marrëveshja paraprake për kryerjen e veprës penale e cila u vihet barrë. Kjo sepse bazuar në deklaratat e të akuzuarve dhe SMS-at e ekzaminuara si prove nga IT në Prishtinë, rezulton se i akuzuari E. P ka komunikuar me persona të ndryshëm lidhur me narkotik, mirëpo asnjë nga këto biseda të zhvilluara nuk kanë të bëjnë me rastin konkret. Andaj, sipas mbrojtjes Gjykata nuk mund të e mbështes aktgjykimin në prova të cilat nuk vërtetojnë elementet e veprës penale konkrete.

Gjithashtu, mbrojtja pretendon se me provat e shqyrtuar në shqyrtimin kryesor nuk është vërtetuar se i akuzuari E. P ka ndërmarrë apo ka tentuar të ndërmarr veprimin e shpërndarjes së substancave narkotike sepse ky veprim vërtetohet vetëm me aktin konkret siç është zënja në flagrancë e shpërndarjes.

Madje, sipas mbrojtjes lidhur me posedimin e substancës narkotike të llojit marihuanë ka arritur parashkrimi absolut i veprës penale, pasi që posedimi i narkotikut sanksionohet konform nenit 275 të KPK, ndërsa ngjarja ka ndodhur me datën 09.11.2016 dhe nga kjo kohë e deri tani kanë kaluar më tepër se 6 vjet.

Për më tepër, mbrojtja thekson se transporti ose dërgimi nënkupton bartjen e substancave nga një vend në vendin tjetër, ndërsa në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me asnjë veprim të

transportit të substancave, pasi të akuzuarit posa janë takuar janë ndalur nga policia e cila i ka identifikuar.

Rrjedhimisht, si pasojë e këtyre paqartësive dhe mungesave në aktgjykimin e përshkruar më lartë, si dhe si pasojë e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mbrojtja pretendon se është bërë edhe shkelje esenciale e dispozitës ligjore nga neni 384 par.2 të Kodit të Procedurës Penale, duke ndikuar kështu edhe në marrjen e një aktgjykimi të drejtë dhe të ligjshëm.

Madje, sipas mbrojtjes si pasojë e pretendimeve të lartcekura Gjykata e shkallës së parë ka bërë edhe zbatimin e gabuar të ligjit penal me rastin e shpalljes së akuzuarit E. P si fajtor dhe me shqiptimin e dënimit me burgim prej dy vitesh ndaj të njëjtit. Mbrojtja shton se konfiskimi i automjetit të regjistruar në emër të V. P (vëllai i E. Pt) si send i përdorur për kryerjen e veprës penale, është i pabazuar në dispozitat ligjore dhe i pa argumentuar me prova konkrete.

Sa i përket vendimit mbi dënimin, mbrojtja thekson se nëse eventualisht Gjykata gjen se në veprimet e të akuzuarit E. P sajohet ndonjë veprim inkriminues, e njëjta duhet që matjen e dënimit ta shqyrtojë konform veprimeve dhe në harmoni me nenin 74 të KPK-së. Sipas mbrojtjes, Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka bërë vetëm përshkrimin e dispozitës së nenit 74 të KPK-së, por nuk ka arsyetuar me prova relevante rrethanat e përgjithshme me rastin e caktimit dhe matjes së dënimit. Andaj, mbrojtja vlerëson se duke marrë parasysh rrethanat lehtësuese të gjetura nga Gjykata, të akuzuarit i është shqiptuar dënim shumë i rëndë dhe jo në proporcion me vlerësimin e fakteve të cekura.

Pretendimet ankimore të mbrojtëses të akuzuarit F. S, av. Fatmire Braha

Mbrojtësja e të akuzuarit F. S, av. Fatmire Braha konsideron se aktgjykimi i atakuar është i pa arsyetuar, i pa argumentuar, i pa qëndrueshëm dhe i kundërligjshëm. Sipas mbrojtjes aktgjykimi i atakuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parapara me dispozitën e nenit 384 par.2 pika 2.5 dhe 2.7 pasi që konsideron se aktgjykimi është bazuar në provë të papranueshme dhe nuk është përpiluar në pajtim me nenin 369 lidhur me nenin 364 par.1 pika 1.1 të KPP.

Sipas mbrojtjes, Gjykata ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parapara me nenin 384 par.2 pika 2.5 të KPP-së kur substancën e përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, nuk ka arritur të e vërtetoj që është substancë narkotike apo preparat i shpallur si

narkotik me Ligji Nr.02/L-128 për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorë dhe as në shtojcat – tabelat për klasifikimin e bimëve narkotike.

Gjithashtu, mbrojtja pretendon se aktgjykimi i atakuar nuk është përpiluar në pajtim me nenin 369 par.4.6 dhe 7 të KPP lidhur me nenin 364 par.1 pika 1.1 të KPP, pasi që të akuzuarin F. S për veprën penale e cila i vihet barrë e ka shpallur fajtor pa i theksuar faktet dhe rrethanat që e përbëjnë figurën e veprës penale nga të cilat varet zbatimi i dispozitës 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 369 par.4 lidhur me nenin 364 par.1 pika 1.1 të KPP.

Po ashtu, sipas mbrojtjes dispozitivi i aktgjyimit të ankimuar është në kundërshtim me vet arsyetimin, pasi që aktgjykimi i mungon arsyetimi në lidhje me faktet vendimtare të vërtetuara nga provat e administruara gjatë procedurës penale lidhur me veprën penale e cila i vihet barrë të akuzuarit F. S, siç parashihet me dispozitën e nenit 369 par. 6 dhe 7 të KPP. Për më tepër, sipas mbrojtjes aktgjykimi i ankimuar nuk mbështetet as në prova konkrete, të artikuluar, të besueshme, bindëse dhe të pranueshme në aspektin ligjor sa i përket ndërmarrjes së veprimeve inkriminuese dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit F. S.

Si pasojë e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, mbrojtja pretendon se në dëm të akuzuarit F. S është bërë edhe shkelje e ligjit penal konform nenit 386 të KPP, meqë konsideron që pretendimet e cekura në aktakuzën e Prokurorisë nuk kanë pasur mbështetje të mjaftueshme në prova konkrete të pranueshme në aspektin ligjor. Kjo sepse për të u plotësuar elementet e figurës së veprës penale e cila i vihet barrë të akuzuarit, duhet të ekzistoj qëllimi dhe dashja për kryerjen e veprës penale, të cilat Prokurori në rastin konkret nuk ka arritur të i argumentoj me prova konkrete. Rrjedhimisht, mbrojtja konsideron se Gjykata vendimi e ka marrë pa u bazuar në asnjë provë e madje edhe në kundërshtim me deklarin e ekspertit Sami Mavriqi i cili ka deklaruar se substanca ekstazi nuk është e paraparë si narkotik me Ligjin e Kosovës. Andaj, mbrojtja propozon që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet dhe ndaj të akuzuarit të nxirret aktgjykim lirues konform neni 363 par.1 pika 1.3 të KPP.

Tutje, mbrojtja konsideron Gjykata ka bërë edhe vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike sa i përket të akuzuarit F. S, konform nenit 386 par.2 dhe 3 të KPP, sepse nuk ka arritur të arsyetoj në mënyrë konkrete dhe individuale në bazë të provave relevante të administruara veprimet inkriminuese të akuzuarit F. S, ashtu siç obligohet në bazë të nenit 369 par.7 të KPP,

që në mënyrë të qartë dhe të plotë të përshkruaj arsyet përse fakte e caktuara i ka konsideruar si të vërtetuara dhe të theksoj provat ligjërisht të pranueshme mbi të cilat është bazuar.

Referuar nenit 360 par.1 lidhur me nenin 8 par.2 të KPP-së sipas të cilit Gjykata e bazon aktgjykimin vetëm në faktet dhe në provat e procedura në shqyrtimin gjyqësor, sipas vlerësimit të mbrojtjes si prova të pranueshme në aspektin ligjor në këtë lëndë penale mund të merren për bazë vetëm procedimi i provave materiale.

Për më tepër, mbrojtja pretendon se duke iu referuar parimit “in dubio pro reo” i cili parashihet me nenin 3 par.2 të KPP-së, Gjykata mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal, është dashur të i interpretoj në favor të akuzuarit dhe të drejtave të tij.

Madje, sipas vlerësimi të mbrojtjes Gjykata e shkallës së parë fillimisht është dashur të konstatoj nëse me provat e propozuara nga Prokuroria dhe palët, ka ekzistuar dyshimi i bazuar mirë për ngritjen e aktakuzës, e jo të lejoj sfidimin ligjor të palëve në mungesë të përmbushjes së këtij kushti të përcaktuar ligjor. Lidhur me këtë mbrojtja shton se Pokruroi i shtetit ka vepruar në kundërshtim me nenin 48 dhe 242 të KPK-së me rastin e ngritjes së aktakuzës.

Andaj, në mungesë të vlerësimit të kualitetit të provave relevante të administruara në shqyrtimin gjyqësor sa i përket përgjegjësisë penale të akuzuarit F. S dhe në mungesë të provave me të cilat inkriminohet ky i akuzuar, mbrojtja konsideron nuk mund të arrihet në përfundimin që gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Ndërkaq, sa i përket vendimit mbi dënimin mbrojtja pretendon se dënimi me burg në kohëzgjatje 2 vite i cili i është shqiptuar të akuzuarit F. S është shumë i lartë dhe i pa bazuar duke marrë parasysh të lartcekurat, si dhe faktin që nuk është i dënuar më parë, është në bashkësi jashtëmartesore dhe është në pritje të lindjes së bashkëshortes së tij.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet e lartë cekura ankimore lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nuk qëndrojnë e madje nuk ka as shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale për të cilat sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo Gjykatë, e të cilat do të kushtëzonin anulimin e aktgjykimin të ankimuar.

Kolegji i Apelit vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parapara nga neni 384 par. 2 nën par. 2.5 dhe 2.7 e lidhur me dispozitat e nenit 369 dhe 364 par.2 pika 2.5 të KPP-së në të cilat thirret mbrojtësja e të akuzuarit F. S, av. Fatmire Braha në ankesë, pasi dispozitivi i aktgjykimi është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, po ashtu, i njëjti është në përputhshmëri të plotë edhe me arsyetimin dhe gjithashtu edhe përpilimi i dispozitivit, është bërë konform dispozitave të nenit 369 par. 4 e lidhur me nenin 364 të KPP-së, ku janë përfshirë të gjitha faktet dhe rrethanat nga të cilat plotësohen të gjitha elementet e veprave penale nga neni 273 par.1 të KPRK-së, për të cilat të akuzuarit janë shpallur fajtor..

Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, po ashtu, janë dhënë arsyet e duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështjeje penale-juridike, duke vepruar kështu, konform dispozitave të nenit 369 par. 6 të KPP-së. Gjykata e shkallës së parë ka paraqitur arsyet faktike dhe juridike për çdo pikë të aktgjykimit, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo Gjykatë. Gjykata e shkallës së parë vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim me dispozitat e nenit 360 par. 1 të KPP-së, duke dhënë arsye të qarta për vendin, kohën, mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe për mënyrën se si ka ardhur deri të kryerja e veprës penale nga të akuzuarit. Pra, Gjykata e shkallës së parë ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive, dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo Gjykatë.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me shkeljet e ligjit penal

Sipas vlerësimi të kësaj Gjykate, me aktgjykimin e ankimuar nuk është shkelur as ligji penal siç pretendoj mbrojtëset e të akuzuarve në ankesat e tyre. Kjo për faktin se veprimet e të akuzuarve i përbëjnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale nga neni 273 par.1 të KPRK-së e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për të cilat të akuzuarit edhe janë shpallur fajtor, se për këtë vepër penale të njëjtit janë penalisht përgjegjës, si dhe nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të të akuzuarve.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me vërtetimin e gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike

Sa i përket pretendimeve ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike Gjykata e Apelit e Kosovës konstaton që gjykata e shkallës së parë edhe gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për shkak se me provat e

administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se të akuzuarit E. P dhe F. S janë kryerës të veprës penale për të cilat janë shpallur fajtor. Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se të akuzuarit në mënyrën e përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, e kanë kryer veprën penale për të cilën janë shpallur fajtor nga fakti se me datë 09.11.2016, rreth orës 21:10 minuta në Mitrovicë, në rrugën “Ali Gaxha” të pandehurit më marrëveshje paraprake dhe në bashkëkryerje pa autorizim kanë blerë me qëllim të shitjes substanca apo preparate të shpallura me ligj si narkotikë, në atë mënyrë që i pandehuri F pasi ka siguruar një sasi të madhe të substancave narkotike të llojit MDMA (e njohur si ekstazi) gjithësejt 504 copë tableta me peshë të përgjithshme prej 207.77 gram dhe me qëllim të ofrimit për shitje në tregun e drogës ka ftuar të pandehurin E që me automjetin e tij të markës “Renault Clio” me tabela të regjistrimit ..., t’i transportojnë narkotikët dhe për këtë qëllim e vendosë këtë sasi narkotikësh në mes dy ulëseve të vozitësit dhe pasagjerit si dhe disa paketime tjera nën ulësen e pasagjerit, por janë zënë në flagrancë nga policia e cila i arreston dhe i konfiskon narkotikët dhe gjatë kontrollimit të pandehurit E në xhepin e tij të pantollonave i gjendet një qese me substanca narkotike e llojit Marihuanë në sasi prej 0.62 gram.

Deri të kjo gjendje faktike, Gjykata e shkallës së parë kishte ardhur pas administrimit provave, siç janë: dëgjimi i ekspertit Sami Mavriqi, administrimi i provave materiale të cilat i ka propozuar prokuroria në aktakuzë si vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes me numër 16-081 i datës 10.11.2016, fotoalbumi nga vendi i ngjarjes me numër 317/2016 i datës 09.11.2016, procesverbali mbi kontrollin e shtëpisë dhe banesave të të pandehurve i datës 10.11.2016, foto dokumentacioni nga vendi i ngjarjes; DVD incizimet nga telefoni mobil i të akuzuarve, raporti i ekzaminimit nga Njësia e IT në Prishtinë të komunikimeve shkresore të pandehurve, raporti i ekspertizës narkotike i AKF me numër AKF/2016-3242/2016-2900 i datës 30.01.2017, regjistrimi i thirrjeve telefonike të kompanisë IPKO në emër të të pandehurve E dhe F, raporti i ekzaminimit të pajisjeve elektronike – telefonave të të pandehurve, fotoalbumi nga sektori për fotografi, video analiza dhe ekzaminimi i IT të DTK, foto dokumentacioni dhe shkresat e tjera të lëndës.

Duke u bazuar në këto prova të cilat janë administruar, vlerësuar dhe analizuar nga ana e Gjykatës së shkallës së parë, por edhe në provat tjera që gjenden në shkresa të lëndës, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për shkak se është vërtetuar se të akuzuarit E. P dhe F. S në bashkëkryerje e kanë kryer veprën penale të lartcekur. Andaj, Kolegji penal

vlerëson se Gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se në këtë çështje penale nuk ka mbetur pa u vërtetuar asnjë fakt vendimtar.

Kurse, lidhur me pretendimin ankimor të mbrojtëses së të akuzuarit E. P, av.Emine Kaçiku dhe mbrojtëses së të akuzuarit F. S, av.Fatmire Braha, se Gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar, se tabletat e gjetura tek i akuzuari F. S çfarë përbërje kanë dhe nëse ajo përbërje kimike është e përfshirë në tabelat e Ligjit nr.02/L-128 për Barnat Narkotike, Substancat Psikotrope dhe Prekursor, në Shtojcën-Klasifikimi i Bimëve, Barnave Narkotike, Substancave Psikotrope, Prekursorëve dhe Përgatesave të tyre dhe se substanca estazi nuk është substancë narkotike sipas ligjit të Kosovës që është i aplikushëm, janë pretendime të pa bazuar pasi nga raporti i ekspertizës narkotike i AFK-së, me numër AKF/20166-324/2016-2900, i datës 30.01.2017 e veçanërisht nga deklarimi i ekspertit të fushës Sami Mavriqi, u vërtetua se substanca narkotike MDMA përndryshe e njohur si ekstazi është drogë e fortë simulative, drogë sintetike, e cila prodhohet nëpër laboratorë të ndryshëm dhe se emri kimik i MDMA-së është Metilen, Dioksid Metamfetaminë sepse është komponim sintetik dhe me bashkëveprimin e substancave ka fituar këtë përbërës, pra prezentë është edhe substanca Metamfetaminë në kuadër të MDMA-së, andaj mbi këtë bazë nuk mund të thuhet se substanca MDMA e njohur si ekstazi nuk është substancë narkotike sipas ligjeve vendore ngase njëri nga përbërësit e tij pra në këtë rast Metamfetamina është substancë narkotike apo preparate e shpallur me ligj si narkotikë.

Në anën tjetër, kjo Gjykatë lidhur me pretendimet ankimore të mbrojtjes të akuzuarit F. S, av. Fatmire Braha se nuk është vërtetuar dashja e të akuzuarit si element i fajësisë dhe pretendimin e mbrojtëses së të akuzuarit E. P, av. Emine Kaçiku se nuk është vërtetuar se në mes të akuzuarve ka ekzistuar marrëveshja paraprake, kjo Gjykatë rikujton se dashja dhe ekzistimi i marrëveshjes paraprake nxjerret nga rrethanat faktike.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me vendimin mbi dënim

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të Prokurorisë për një dënim me të ashpër dhe pretendimet e mbrojtësve të akuzuarve për një dënim më të butë nuk janë të bazuara.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka marrë parasysh dhe ka vlerësuar drejt të gjitha rrethanat që konform dispozitës së nenit 69 të KPRKsë ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Kështu si rrethanë lehtësues për të akuzuarin E. P ka

vlerësuar faktin se i njëjti ka treguar sjellje shumë korrekte në gjykatë në raport me gjykatën dhe palët, pastaj faktin se në kohën kur e ka kryer këtë veprë penale ka qenë i moshë relativisht të re, se nga koha kur është kryer vepra penale ka kaluar një kohë e gjatë afërsisht 7 (shtatë) vjet, ndërsa si rrethanë rënduese ka vlerësuar përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë, motivin me të cilin kanë vepruar- me qëllim të përfitimit të dobisë materiale, pastaj te kaluarën e tij pasi që nga sistemi i evidencës penale pranë kësaj gjykate i njëjti është shpallur fajtor edhe me tri aktgjykime P.nr.469/2015, P.nr.301/2021 dhe P.nr.712/2021. Për të akuzuarin F. S si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar faktin se i njëjti ka treguar sjellje shumë korrekte në gjykatë në raport me gjykatën dhe palët, pastaj faktin se në kohën kur e ka kryer këtë veprë penale ka qenë i moshë relativisht të re, se nga koha kur është kryer vepra penale ka kaluar një kohë e gjatë afërsisht 7 (shtatë) vjet. Ndërsa si rrethanë rënduese ka vlerësuar dashjen direkte të akuzuarit dhe shkallën e lartë të dashjes së shprehur, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë, kontributin esencial në këtë veprë penale, motivin me të cilin kanë vepruar- me qëllim të përfitimit të dobisë materiale, pastaj te kaluarën e tij pasi që nga sistemi i evidencës penale pranë kësaj gjykate i njëjti është shpallur fajtor edhe me një aktgjykim P.nr.83/2018, për veprë penale nga ky kapitull. Duke i pasur parasysh rrethanat e lartcekura Gjykata e shkallës së parë të akuzuarit i ka shqiptuar dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindjen se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se Gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa rrethanat e pretenduara rënduese në ankesën e Prokurorit se dënimi është tejet i butë dhe nuk i përgjigjet intensitetit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale shkallë së papërgjegjësisë dhe pasojave të shkaktuara, janë pretendime të cilat veç se kanë qenë objekt vlerësimi nga Gjykata e shkallës së parë dhe të nuk kanë ndikim që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim tjetër nga ai i cili i është shqiptuar. Andaj, të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të Kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga Gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve nga ana e Gjykatës së shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve, intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se me të do të mund të parandalohet i akuzuari nga

kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga arsyet e sipërcekura, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Departamenti për Krime të Rënda
PAKR.nr.603/2023, dt. 07.02.2024

Bashkëpunëtorja profesionale

Anëtarët e kolegjit

Kryetar i kolegjit

Blerina Sallauka

Kadrije Goga Lubishtani

Hashim Çollaku

Xhevdet Abazi